



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, Trupi Gjykes nxori Vendimin e Gjashtë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave më 8 mars, ndërsa versioni i redaktuar publik doli të premtën e javës së shkuar. Vendimi gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Në Vendim, gjykatësit pranuan tre parashtues të tjerë kërkesash si viktimat pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, të cilët do të përfshihen në grupin ekzistues të viktimave pjesëmarrëse dhe do të përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës viktimash. Bashkë me ta, numri i gjithsejtë i viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore arrin në 140.

Dje, Kryetarja e DSK-së, Ekaterina Trendafilova, caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me apelin e paraqitur nga një mbrojtës që përfaqëson 19 persona të cilëve iu rrëzua kërkesa për të marrë pjesë si viktimat në procesin gjyqësor, si dhe lidhur me apelin e paraqitur nga një mbrojtës tjetër, përfaqësues i një personi të cilit gjithashtu iu rrëzua kërkesa për pjesëmarrje. Anëtarët e Panelit janë gjykatësjatë Mishelë Pikar, gjykatësi Emilio Gati dhe gjykatësi Kai Ambos.

Në vijim të një urdhri të Trupit Gjykes në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, Prokuroria dorëzoi më 10 mars informacion për kohën që parashikon se do të nevojitet për marrjen në pyetje të 12 dëshmitarëve të parë në këtë çështje gjyqësore nga Prokuroria, Mbrojtja dhe mbrojtësi i viktimave.

Prokuroria parashikon se do të nevojiten gjithsej 234 orë e gjysmë për marrjen në pyetje të këtyre dëshmitarëve. Në bazë të Rregullores dhe Urdhrit të Trupit Gjykes mbi Zhvillimin e Procesit, çdo dëshmitar i thirrur nga Prokuroria do të pyetet në fillim prej Prokurorisë. Më pas mbrojtësi i viktimave do të ketë mundësi t'i bëjë pyetje dëshmitarit, me kërkesë, dhe nëse e lejojnë gjykatësit. Pas kësaj, Mbrojtësit e të akuzuarve do të kenë mundësi t'i bëjnë pyetje dëshmitarit dhe, në përputhje me Rregulloren, Trupi Gjykes gjithashtu mund t'i drejtojë pyetje dëshmitarit.

Deklaratat hyrëse nga Prokuroria, mbrojtësi i viktimave dhe Mbrojtja janë planifikuar të mbahen më 3, 4 dhe 5 prill 2023, ndërsa paraqitja e provave nga Prokuroria është planifikuar të fillojë më 11 prill 2023. Konferenca për ecurinë e çështjes gjyqësore do të mbahet më 20 mars, që u paraprin deklaratave hyrëse. Rendi i ditës për këtë seancë përgatitore doli dje dhe gjendet në faqen e internetit të DSK-së.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, versioni i redaktuar publik i dosjes paraprake të Kadri Veselit u dorëzua këtë javë. Versioni konfidencial i dosjes u dorëzua në tetor 2022.





Dosja paraprake e Mbrojtjes është një dokument ku Mbrojtja e të akuzuarve përshkruan në përgjithësi natyrën e mbrojtjes së të akuzuarit, akuzat dhe pikat që i akuzuari kundërshton dhe arsyet pse i kundërshton, si dhe një listë me dëshmitarët e mundshëm që Mbrojtja synon të thërrasë gjatë gjyqimit.

Seancat në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala* rifillojnë më 27 mars në orën 9:30, me fillimin e paraqitjes së provave dhe thirrjen e dëshmitarëve nga Prokuroria.

Për shkak të arsyeve humanitare bindëse, Gjykatësi i Vetëm udhëzoi Zyrën Administrative të organizonte një vizitë humanitare të z. Gucati në Kosovë, për të takuar anëtarët e familjes së ngushtë. I akuzuari shkoi atje si i paraburgosur dhe nën ruajtjen e Dhomave të Specializuara. EULEX-i dhe Policia e Kosovës i ndihmuan Dhomat e Specializuara të Kosovës gjatë vizitës. Vizita si i paraburgosur përfundoi dhe z. Gucati është kthyer në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Më herët gjatë kësaj jave, në kuadër të aktivitetet të Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim, përfaqësues të DHSK-së morën pjesë në një punëtori të organizuar nga EULEX-i lidhur me qasjen në dokumente publike. Përfaqësuesit e DHSK-së gjithashtu organizuan një tryezë të rrumbullakët në Prishtinë me gazetarë, për t'u dhënë informacion mbi mënyrën e raportimit lidhur me gjykimet e DHSK-së.

Pyetje nga gazetarët

